



Këshilli Kombëtar i Restaurimeve ka miratuar projektin e restaurimit: “Kisha Shën e Premte”, Sop, Fier



Projekti i hartuar nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore parashikon ndërhyrje konservuese dhe restauruese në elementët konstruktivë të kishës.

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore mirëpret çdo bashkëpunim dhe mbështetje që kontribuon në ruajtjen e trashëgimisë sonë kulturore.

Kisha Shën e Premte, Sop



Ndërtim me muraturë me tulla silicate, e kryer midis viteve 1976-1979. Muratura është realizuar për vendosjen e çatisë, e cila sot nuk ekziston më.


Çmontim i muraturës dhe realizimi i një çatie të re. Gjatë ndërtimit të çatisë, të kryhen konsolidimet e nevojshme dhe sipas rastit të muraturës.

Patinë biologjike në të gjithë fasadën, vegetacion dhe bimësi në lartësi

Pastrim me kujdes nga vegetacioni, bimësia dhe patina biologjike. Sprucim me herbacid. Pas pastrimit të bëhet konsolidim i muraturës dhe më pas fugatim.

Mungesë guri në muraturë

Plotësim me muraturë guri



Ndërtim çatie me tegjula. Lartësia e çatisë do të diktohet pas pastrimit dhe përforcimit të qemerit dhe vendosjes së një shtrese llaçi horasan

Mur me gurë, për mbajtjen e çatisë.

Pastrim i të gjithë sipërfaqes dhe evidentim i teknikës së muraturës.

Plotësim me mur me gurë



— facebook.com/lmk.gov.al